



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-1341

Dt. 07.02.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Qazim (Dervish) Tola** nga Gjakova, për dhënjën e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual, me etazhitet P+1, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenit 14, 15, 19, 20 dhe 21, Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr.2003/14 nenit 17, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

AKTVENDIM

I. ILEJOHET: aplikuesve: Qazim (Dervish) Tola nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual, sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Rregullues Urban “Dardania Përendimore”, si dhe Kushtet Ndërtimore me nr. 07-351-39260, dt. 16.08.2016, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale me nr. 1586/1, Z.K. Jahoc, në rrugën “Pashko Vasa”, në pronësi të të lartëpërmendurit, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është P+1, me sipërfaqe të përgjithëshme (bruto) të objektit **S=184.20 m²**.

Përdhesa: (Sip,Bruto): **S= 90.30 m²**
Kati i parë: (Sip,Bruto): **S= 93.90 m²**

II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit i objektit të banimit individual, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë byroja projektuese “Tower Project” Gjakovë.

IV. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

V. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

VI. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

Arsyetim

Qazim (Dervish) Tola nga Gjakova, me banim në rrugën "Pashko Vasa" ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-1341 të datës 25.01.2017 për dhënjen e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual, me etazhitet P+1, në ngastrën kadastrale me nr. 1586/1, Z.K. Jahoc, në rrugën "Pashko Vasa", siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 05.04.2016, të punuar nga N.SH"Geogauss"-Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 03.08.2016 (fotokopje) në pronësi të QAZIM (DERVISH) TOLA nga Gjakova, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikaten mbi të drejtën në pronën e paluajtshme (fotokopje) me nr. të lëndës 4471/16, të datës 03.08.2016, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Kushtet Ndërtimore, me nr. 07-351-39260, të datës 16.08.2016, për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit të banimit individual, në ngastrën kadastrale me nr. 1586/1, ZK:jahoc, të lëshuar nga DUMM.
5. Pëlqimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, me nr.08-320-01-1642, dt.27.01.2017, nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
6. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr 430-L-2090 të datës 17.08.2016.
7. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, të datës 31.08.2016.
8. Pëlqimin nga K.R.U."Radoniqi"Sh.A.Gjakovë, të datës 24.08.2016.
9. Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, dt. 23.08.2016.
10. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në IFJB Capital, filiala Gjakovë me datë 01.02.2017.
11. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, byroja projektuese "Tower Project" Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 820.26 Euro.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor në Prishtinë, dhe e njejta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspektionit,
- Arhivës.

Zyrtar i lartë për çështje juridike

Zenel Shabani, jur. dipl.

U.D. Drejtori


Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.

KOPJE PLANI

Z.K. Jahoc
Poseduesi: 1 /1 Tola Qazim (Dervish)

Shk. zvog. 1: 500

Veriu



Numri rendor i regjistrimit të taksave kadastrale: _____

Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet	
					Ha	a	m ²		
1586-1	-	-	are	4	0	05	06		
Gjithësejtë						0	05	06	

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastër duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

VËRTETON:
Arber Jusufi